

VENDIM
Nr. 651, datë 8.10.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESEMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË
NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, miratuar në datën 26.6.2014, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1.8., të vendimit nr. 532, datë 7.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1.9., me këtë përmbajtje:

“1.9. Në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore (RC-C), në operacionin ushtarak “ISAF”, Kabul, Afganistan.

a) Misioni: Mbështetje dhe dhënie kontributi në funksione të ndryshme në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore, në operacionin ushtarak “ISAF”, Kabul, Afganistan.

b) Numri i pjesëmarrësve: 2 (dy) ushtarakë.

c) Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në datën 31.12.2014.

ç) Venddislokimi: në Shtabin e Komandës Rajonale Qendrore në Kaia, Kabul, Afganistan.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama